



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 14.2.2023

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të seancës gjyqësore publike të datës 7.2.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar dhe në aktin nr.187/1 prot., datë 16.5.2022, “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar prej tre vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nga ana e Kolegjit u vendos të çelet hetimi gjyqësor i çështjes dhe të pranohen në cilësinë e provës aktet e reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 7.2.2023, së bashku me prapësimet, depozitoi edhe disa akte të reja, një prej të cilëve u pranua në cilësinë e provës nga trupi gjykues, ndërsa të tjerat, të cilat në shumicën e tyre referojnë përmbajtje të legjislacionit shtetëror dhe federal të SHBA-së në fushën e taksave, rezidencës, azilit dhe përfitimeve të tjera shoqërore, u refuzuan, me arsyetimin se duke qenë se gjenden në burime të hapura zyrtare, do të aksesohen dhe vlerësohen nga trupi gjykues, nën dritën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik, në referencë të shkaqeve të ankimit, vlerëson se edhe akti i administruar në cilësinë e provës nga ana e Kolegjit, nuk ndryshon qëndrimin e Komisionerit Publik, mbajtur në ankimin e datës 24.5.2022, ndaj vendimit nr. 519, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi, sikundër do të trajtohet në mënyrë të përmbledhur në vijim:

**1. Për pasurinë shtëpi me sip. 180 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\* \*\*\*, \*\*\*, New York \*\*\*(SHBA), Komisioneri Publik, bazuar edhe në rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së,<sup>1</sup> për sa trajtuar gjerësisht në Ankimin e datës 24.5.2022, prg. 16.7.1 deri në 16.7.4. vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte/prova të reja dhe nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me pasaktësinë në deklarambi shumë e kredisë disbursuar nga \*\*\* \*\* Bank dhe pamjaftueshmërinë e konstatuar për pagesën e këstit të dytë, në shumë 46.680 USD, pamjaftueshmëri që lidhet me mungesën e dokumentimit të të ardhurave të ligjshme, për periudhën gusht 2003 - dhjetor 2004. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, nuk arriti të provojë si pamundësinë objektive të pretenduar për administrimin e akteve nga organet përgjegjëse për këtë periudhë, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 24.5.2022, duke mbajtur në konsideratë rrethanat e parashtruara në Rekomandimin<sup>2</sup> për paraqitje ankimi, datë 16.5.2022, ashtu dhe të ardhurat e pretenduara të siguruara nga ai dhe personat e tjerë të lidhur me të, për periudhën shtator 2003 - dhjetor 2004.**

1.1 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, mbi reduktimin në analizën financiare të kryer për periudhën e analizuar, të zërit: “shpenzime për qira banese”<sup>3</sup>, si pjesë përbërëse e shpenzimeve të jetesës sipas indeksit të pragut të varfërisë, të llogaritur nga Komisioni, konstatohet se nga analiza e akteve në dosje të Komisionit, nuk rezulton që ky pretendim të jete pjesë e prapësimeve të subjektit në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, edhe pse gjatë hetimit i është vënë në dispozicion analiza e kryer me zërat përbërës dhe subjekti ka kontestuar disa prej tyre, trajtuar gjerësisht në ankim.

1.2 Bazuar në sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në konsideratë të kryerjes së analizës financiare, duke nisur që nga viti 2003 (muaji shtator), marrë në konsideratë si të ardhura në dispozicion të subjektit dhe familjarëve të tij, për periudhën 2003-2004, edhe shumë prej 20.000 USD (deklaruar të marrë *cash*) dhe shpenzimet minimale të jetesës për të njëjtën periudhë, nga rezultatet e analizës financiare do të rezultonte pamjaftueshmëri financiare për periudhën shtator 2003 - \*\*5.2012 dhe subjekti i rivlerësimit do të gjendej në kushtet e deklarambi të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasurinë “Shtëpi me sip.180 m<sup>2</sup>, në New York, SHBA” .

**2. Për pasurinë e luajtshme, depozita në \*\*\* Bank dhe \*\* Bank në New York, SHBA, Komisioneri Publik, bazuar në rrethanat e parashtruara në Rekomandimin<sup>4</sup> e ONM-së, për sa trajtuar gjerësisht në ankimin e datës 24.5.2022, vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti akte/prova të reja dhe nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit, z. Gramshi, personave të lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të kursimeve në depozitat bankare deri në datën \*\*7.2014.**

<sup>1</sup> Referohuni pikës 2, germa “a”, faqe 2-6 të Rekomandimit të ONM-së.

<sup>2</sup> Referohuni pikës 2, germa “c”, faqe 9; germa “a”, faqe 6; dhe germa “b”, faqe 7-8 të Rekomandimit të ONM-së.

<sup>3</sup> Referohuni f. 27 të Parashtrimeve të datës 2.2.2023, paraqitur nga ana e subjektit të rivlerësimit në Kolegj.

<sup>4</sup> Referohuni pikës 2, germa “b”, faqe 8-9 të Rekomandimit të ONM-së.

2.1 Sikundër arsyetuar më sipër, për pasurinë “Shtëpi me sip. 180 m<sup>2</sup>, në New York, SHBA”, në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe në këtë rast duhen vlerësuar burimet financiare për periudhën duke filluar që nga muaji shtator 2003. Subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk provoi pamundësinë objektive për vënien në dispozicion të akteve mbi të ardhurat e periudhës shtator 2003 - dhjetor 2004 dhe, rrjedhimisht, edhe për justifikimin me burime të ligjshme të pasurive të luajtshme (depozitave bankare) dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të identifikuar për periudhën shtator 2003 - \*\*7.2014, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b”, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

2.2 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit duket se referojnë në situata të prezumuara, verifikimi i të cilave mungoi të provohet me akte, në përmbajtjen e të cilave të mund të bazoheshin prapësimet e parashtruara në seancën e kaluar gjyqësore.

3. Përveç sa më sipër trajtuar, Komisioneri Publik, bazuar në aktin “Rekomandim për paraqitje ankimi”, vlerëson se pamjaftueshmëria e konstatuar ndër vite, trajtuar në dy çështjet e mësipërme, do të ndikonte dhe rezultatin financiar të akumuluar të vitit 2015, duke e kthyer atë në negativ.<sup>5</sup>

### **Kërkimi i ankimit**

4. Duke përfunduar për sa parashtruar, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 519, datë 25.3.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kastriot Gramshi.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>5</sup> Referohuni f. 10 të Rekomandimit [...] Për vitin 2015, balanca negative është në shumën -21.149 USD, në këtë vit, subjekti ka shlyer shumën 8.532 USD për huan e bashkëshortes. Balanca negative në fund të vitit 2015 tregon se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar pjesërisht huan (në referencë të paragrafit 72.4 të vendimit të Komisionit) [...].